



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE
SEKTORI I AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË

PROCESI I VETËVLERËSIMIT TË OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

RAPORT KOMBËTAR PËR PROCESIN DHE REZULTATET

PERIUDHA E VETËVLERËSIMIT

2020-2021

Tabela e përmbajtjes

SHKURTIMET.....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
KONTEKSTI HISTORIK	5
KUADRI RREGULLATOR PËR VETËVLETËSIMIN (QA) NË SISTEMIN E AFP-SË NË SHQIPËRI	6
INSTRUMENTI DHE METODOLOGJIA E VETËVLERËSIMIT	8
PLANI I ZBATIMIT TË PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2021-2022 NË OFRUESIT E AFP-SË.....	9
REZULTATET E PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2020-2021.....	10
KONKLUSIONE.....	36
REKOMANDIME	37

SHKURTIMET

AFP	Arsim dhe Formim Profesional
IoAFP	Institucion ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional
SD4E	Programi i Zhvillimit të Aftësive për Punësim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
IoAFP	Institucione ofruese të arsimit dhe formimit profesional
QFP	Qendër e Formimit Profesional
QA	Sigurimi i Cilësisë
SKPA	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
NJZH	Njësia e Zhvillimit
OJF	Organizata jofitimprurëse
RN	Rezultatet e të nxënësve
PEI	Plane Edukative Individuale

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Udhëzimin nr. 18, datë 6.7.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”*”, ofruesit publikë të AFP-së kanë zbatuar procesin e vetëvlerësimit sipas një kalendari të miratuar nga AKAFPK, kanë mbledhur të dhënat dhe kanë hartuar raportin përfundimtar të vetëvlerësimit.

Në përfundim të procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2020-2021, u mbledhën të gjitha raportet e dërguara nga ofruesit e AFP-së, të cilat u analizuan nga sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së, gjatë periudhës qershor-dhjetor 2022, për të përgatitur raportin përmbledhës për rezultatet e vetëvlerësimit në nivel kombëtar.

Në këtë raport është prezantuar kuadri historik dhe kuadri rregullator për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri, me institucionet shtetërore të përfshira dhe përgjegjësitë e tyre.

Pasi është prezantuar instrumenti, metodologjia e vetëvlerësimit, si dhe kalendari i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit për vitin 2020-2021, janë prezantuar rezultatet e ofruesve të AFP-së për të pesë fushat e cilësisë. Në këtë raport është paraqitur analiza cilësore dhe sasiore e të dhënave të mbledhura nga raportet e vetëvlerësimit, si dhe nga platforma *scvet.al* dhe pasi janë identifikuar çështjet që kanë nevojë për përmirësim, janë formuluar rekomandimet përkatëse sipas nënfushave.

KONTEKSTI HISTORIK

Sistemi i AFP-së në Shqipëri është një sistem kryesisht me bazë shkollën dhe me pjesëmarrje shumë të ulët dhe të kufizuar të sektorit privat, në hartimin dhe ofrimin e programeve të arsimit. Në sistemin e AFP-së, AKAFPK ka zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe ruajtjen e kualifikimeve profesionale, i cili mbështet rëndësinë e kualifikimeve për tregun e punës. Në sfondin e politikave 10 vitet e fundit janë bërë përpjekje të shumta për ta zhvendosur fokusin drejt AFP-së dhe rezultatet kanë qenë të dukshme, ndër të cilat mund të përmendim aktivizimin për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kuadrit të kualifikimeve profesionale, përmirësimin e procesit të të nxënës duke e vënë theksin te rëndësia e të nxënës me bazë punën, rritjen e ndjekjes së shkollave profesionale, promovimin e AFP-së përmes aktiviteteve promocionale dhe konkurruese etj. Një përpjekje e mirë është gjithashtu pjesëmarrja e biznesit në bordet e shkollave, me synim rritjen e kontributit të sektorit privat dhe pjesëmarrjen më aktive dhe më efikase të tij në AFP, duke plotësuar hendekun që ekziston mes arsimit profesional dhe tregut të punës, si dhe duke rritur cilësinë.

Projekti SD4E, në bashkëpunim të ngushtë me AKAFPK dhe grupe të tjera interesi, punoi për të përcaktuar tiparet e dëshiruara dhe fizibilitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë. Tashmë viti shkollor 2020-2021 ishte viti i katërt i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit, i cili dëshmon për një rritje të ndërgjegjësimit të ofruesve të AFP-së, për rolin e procesit të vetëvlerësimit në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Një grup kriteresh dhe standardesh minimale të pranuar, pjesë e instrumentit të vetëvlerësimit, zbatohen çdo vit nga të gjithë ofruesit publikë të AFP-së në Shqipëri, të cilat përbëjnë bazën e modelit të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në AFP, drejt modernizimit të kontekstit të arsimit profesional dhe garancisë që të diplomuarit e AFP-së të kenë njohuritë dhe kualifikimet për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit në 44 institucione ofruese publike të AFP-së, ka evidentuar aspektet pozitive dhe ato problematike, në të pesë fushat e cilësisë dhe rezultatet e procesit të vetëvlerësimit janë mbajtur në konsideratë për hartimin e raportit kombëtar të vetëvlerësimit.

1 Udhëzuesi Metodologjik për Hartimin e Përshkrimeve të Kualifikimeve Profesionale në Shqipëri (2009),

KUADRI RREGULLATOR PËR VETËVLETËSIMIN (QA) NË SISTEMIN E AFP-SË NË SHQIPËRI

Kuadri strategjik

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, miratuar me Vendim nr. 176, datë 26.2.2020 ka si objektiv të përgjithshëm promovimin e punëve cilësore dhe të mundësive për aftësi për të gjitha gratë dhe burrat shqiptarë gjatë gjithë jetës; ky objektiv do të ndiqet me një sërë masash plotësuese dhe të ndërlidhura që njëkohësisht mbështesin ofertën e punës, nxisin kërkesën për punë dhe trajtojnë përjashtimin e thellë social. Strategjia është e përqëndruar në katër shtylla ose linja masash që programi synon të arrijë. Një nga katër prioritetet strategjike (shtylla B) e SKPA 2019-2022 fokusohet në *“ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit”*, duke e vënë theksin te masat që synojnë përmirësimin e cilësisë së ofrimit në nivelin e ofruesve të AFP-së.

Kuadri ligjor

Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”, kreu V “Sigurimi i Cilësisë” përcakton bazën për zhvillimin e një kuadri të sigurimit të cilësisë në sistemin shqiptar të AFP-së, duke përfshirë licencimin, vetëvlerësimin, inspektimin dhe akreditimin.

Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” (KSHK), i ndryshuar dhe i përmirësuar në vitin 2018 (Ligji nr. 23/2018, datë 10.5.2018), përshkruan veçoritë kryesore të KSHK-së, si strukturën, fushën e veprimit, objektivat dhe funksionet, si dhe masat për qeverisjen, menaxhimin institucional, sigurimin e cilësisë dhe financimin. Fokusi kryesor i parashikuar nga ligji, ndër shumë të tjera, thekson çështjen e sigurimit të cilësisë në AFP. Kjo do të thotë që të gjitha institucionet e arsimit dhe formimit profesional duhet të plotësojnë standarde të caktuara të cilësisë përsa i përket burimeve njerëzore dhe fizike, sistemeve dhe procedurave, menaxhimit, procesit të të nxënies etj. Sigurimi i cilësisë duhet të jetë guri i themelit i çdo institucioni që ofron arsim dhe formim profesional dhe një aspekt shumë i rëndësishëm për përmirësimin e imazhit të AFP-së dhe prodhimin e një force punëtore të kualifikuar për tregun e punës.

Për më tepër, kuadri ligjor për arsimin parauniversitar (Ligji nr. 69/2012 dhe legjislacioni dytësor përkatës) parashikon rregullat dhe kriteret për kuadrin e zhvillimit institucional dhe të cilësisë, veçanërisht për ofruesit e AFP-së që ofrojnë programe të arsimit të mesëm të lartë. Janë përcaktuar procedura dhe kriteret të qarta lidhur me : 1) planin strategjik afatmesëm (4 vjeçar); 2) planin vjetor të punës dhe 3) fushën e veprimit, zbatimin dhe përdorimin e vetëvlerësimit të institucioneve parauniversitare, duke përfshirë shkollat e AFP-së.

Së fundi, *Udhëzimi nr.16, datë 8.05.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë* i ndryshuar me *Udhëzimin nr. 18, datë 6.07.2021*, i cili miraton Udhëzuesin Zyrtar për vetëvlerësimin dhe përcakton përgjegjësitë e ofruesve dhe institucioneve në nivelin qendror, përcaktojnë arritjen e parë kyçe për një zbatim gjithëpërfshirës të kuadrit të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë të gjithë ofruesit publikë të AFP-së, shkollat e AFP-së dhe qendrat e formimit profesional.

Kuadri institucional për sigurimin e cilësisë në AFP

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në cilësinë e institucionit më të lartë përgjegjës për politikën e AFP-së, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është besuar me ligj detyra e krijimit të kuadrit të sigurimit të cilësisë në sistemin e AFP-së, duke përfshirë të gjithë komponentët e këtij sistemi, siç janë licencimi, hapja dhe mbyllja e ofruesve publikë të AFP-së, si dhe miratimi i legjislacionit dytësor për vetëvlerësimin, akreditimin, monitorimin dhe inspektimin. Më konkretisht, Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e bazës ligjore, garantimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare dhe sigurimin e infrastrukturës. Në sektorin publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për miratimin e hapjes, organizimit dhe mbylljes së ofruesve publikë të AFP-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Ajo miraton ofrimin e programeve të AFP-së në bazë të kualifikimeve kombëtare të ofruara nga ofruesit publikë të AFP-së dhe miraton modelin, standardet dhe kriteret e akreditimit të propozuara nga AKAFPK. Ministria bashkëpunon ngushtë me Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe jep miratimin fillestar përsa i përket licencimit të ofruesve privatë të AFP-së. Ministria e Financave dhe Ekonomisë i takon gjithashtu një nga funksionet kyçe të sigurimit të cilësisë, i cili është inspektimi.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)

AKAFPK është institucioni përgjegjës për krijimin e një sistemi të unifikuar të kualifikimeve profesionale të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, një sistem që u mundëson nxënësve/kursantëve/individëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca për të përballuar sfidat e zhvillimit social-ekonomik të vendit. AKAFPK mbështet ministrinë përgjegjëse për të forcuar dimensionin evropian të sistemit shqiptar të kualifikimeve. Në sektorin e AFP-së, AKAFPK ka përgjegjësi dhe kompetencë të plotë për të ushtruar funksionet kryesore të KSHK-së. Ndër detyrat e tjera dhe në lidhje me zbatimin e ligjit për KSHK-në, AKAFPK kryen vlerësimet e kualifikimeve profesionale dhe i krahason ato me kualifikimet ndërkombëtare, si dhe propozon ndryshime në kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të përfshira në KSHK.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Bazuar në nenin 9 të ligjit për AFP-në, AKPA është përgjegjëse për menaxhimin e rrjetit të ofruesve publikë të AFP-së dhe me këtë detyrë, AKPA është përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë së përditshme të ofruesve të AFP-së. Krahas kësaj, AKPA-së i është besuar detyra e mirëmbajtjes dhe përditësimit të regjistrit kombëtar të certifikatave, si dhe detyra e gjurmimit të nxënësve të AFP-së pas diplomimit/certifikimit.

INSTRUMENTI DHE METODOLOGJIA E VETËVLERËSIMIT

Elementët e metodologjisë së procesit të vetëvlerësimit në AFP, përfshijnë 5 dimensionet e cilësisë së veprimtarisë së ofruesve të AFP-së. Instrumenti i vetëvlerësimit i hartuar me mbështetjen e programit SD4E ka shërbyer për të udhëhequr zbatimin e procesit të vetëvlerësimit dhe shpjegon në mënyrë të hollësishme të gjitha fushat, duke përfshirë nënfushat e secilës fushë. Ai përfshin përshkrimet e fushave, nënfushave, kritereve, niveleve të vlerësimit dhe standardeve.

Fusha nënkupton një dimension themelor të veprimtarisë së ofruesit të AFP-së dhe lidhet drejtpërdrejt me të gjithë veprimtarinë e tij. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin profesional dhe arsimin e përgjithshëm. Janë përcaktuar këto fusha kryesore të vetëvlerësimit:

- I. Menaxhimi dhe drejtimi
- II. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi
- III. Kurrikula e zbatuar
- IV. Mësimdhënia dhe të nxënës
- V. Vlerësimi

Nënfusha është një nën-ndarje me detaje dhe elemente që tregon dhe plotëson më së miri, përmbajtjen e një fushe të caktuar në të cilën punon ofruesi i AFP-së. Për shembull, nëse njëra nga fushat është *“Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi”*, nënfushat janë *“Marrëdhëniet me komunitetin dhe shoqërinë civile”*, *“Marrëdhëniet me biznesin”* etj.

Këto nënfusha synojnë të identifikojnë se çfarë marrëdhëniesh dhe çfarë forma bashkëpunimi ka institucioni i AFP-së me partnerët e tij. Ato konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të vëzhguar dhe për të vlerësuar në imtësi atë që ndodh brenda ofruesit të AFP-së. Pra nënfushat kryejnë dy funksione:

- zbërthejnë fushën në elementë organik të domosdoshme për të;
- mundësojnë njohjen dhe vlerësimin real të situatës brenda ofruesit të AFP-së.

Treguesi është një fjali e matshme pohuese që tregon se si është dhe si duhet të jetë fusha. Përmes treguesve, ne vlerësojmë se si është vetëvlerësuar ofruesi i AFP-së.

Karakteristikat e treguesve:

- hartohen për secilën nënfushë dhe mund të jenë një ose disa të tillë;
- janë gjithnjë të matshëm, gjë që do të thotë se ata lehtësojnë procesin e vetëvlerësimit;
- paraqesin pohime që specifikojnë fushën që do të vlerësohet.

Kriteri është një nën-ndarje e treguesve i shprehur në formën e një fjalie që përcakton si është zbatuar, si është organizuar apo në ç'gjëndje paraqitet treguesi. Ai sugjeron mbledhjen e informacioneve dhe mundëson arritjen e treguesve nga institucioni i AFP-së.

Nivelet e vlerësimit janë nivelet e përdorura për vlerësimin e institucionit të AFP-së nëpërmjet fushave të tij. Vlerësimi kryhet për çdo kriter të secilit tregues të një fushe. Nivelet e vlerësimit janë katër: “*shumë mirë*” që përkon me numrin 1; “*mirë*” që përkon me numrin 2; “*mjaftueshëm*” që përkon me numrin 3; dhe “*dobët*” që përkon me numrin 4. Së fundmi me ndryshimet e Udhëzimit nr. 18, datë 6.07.2021 është shtuar edhe një kolonë “*pa vlerësim*” që përkon me numrin 5. Skema me katër nivele vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimet e ofruesve të AFP-së në vendet e Evropës. Po ashtu, ky sistem me katër nivele mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijnë institucionet e AFP-së sipas treguesve.

Standardi është përshkrimi i situatës së ofruesit të AFP-së për secilën fushë, i cili mundëson një vlerësim sipas niveleve të mësipërme të vlerësimit. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave të instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit, të siguruara për secilin tregues dhe kriter, por edhe i të dhënave të siguruara nga metodologjia e zbatuar gjatë vlerësimit të brendshëm. Vlerësimi përfundimtar për një fushë specifike bazohet gjithmonë në peshën dhe rëndësinë e zbatimit të secilit tregues dhe kriter në situatën e ofruesit të AFP-së.

KALENDARI I ZBATIMIT TË PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT NË INSTITUCIONET OFRUESE T AFP-SË

Nr	Hapat që duhen ndërmarrë	Afati	Personat përgjegjës
1	Krijimi i ekipit qendror të vetëvlerësimit	15 nëntor 2021	Drejtori i IoAFP-së
2	Miratimi i ekipit të vetëvlerësimit nga këshilli i mësuesve	19 nëntor 2021	Këshilli i mësuesve
3	Hartimi i planit të vetëvlerësimit për 5 fushat e veprimtarisë	26 nëntor 2021	Ekipi i vetëvlerësimit

4	Miratimi i planit të vetëvlerësimit nga drejtori	30 nëntor 2021	Drejtori i IoAFP-së
5	Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit (plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni etj.) për 5 fushat e veprimtarisë	1 dhjetor 2022	Ekipi i vetëvlerësimit, drejtori, bordi i shkollës, mësuesit, nxënësit/kursantët, bizneset
6	Përpunimi i të dhënave dhe përpilimi i raportit të vetëvlerësimit për 5 fushat e veprimtarisë	30 prill 2022	Ekipi i vetëvlerësimit
7	Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit për 5 fushat e veprimtarisë	10 maj 2022	Ekipi i vetëvlerësimit
8	Monitorimi dhe mbështetja e procesit të vetëvlerësimit nga specialistë të AKAFPK	Nëntor - maj 2022	Specialistë të AKAFPK, S4E
9	Miratimi i raportit të vetëvlerësimit nga këshilli i mësuesve dhe bordi i shkollës	13 maj 2022	Drejtori i IoAFP-së/ këshilli i mësuesve/ Bordi i shkollës
10	Hedhja e raportit final të vetëvlerësimit në platformën digjitale	16 maj 2022	Drejtori i IoAFP-së

REZULTATET E PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2020-2021

Procesi i vetëvlerësimit u finalizua nga 44 ofrues të AFP-së, të cilët i dorëzuan raportet e vetëvlerësimit për periudhën 2020-2021, sipas afateve të përcaktuara. Rezultatet e raporteve u përpunuan dhe u përmbledhën nga specialistët e AKAFPK-së në sektorin e akreditimit të Ofruesve të AFP-së, të cilët analizuan të dhënat sasiore dhe cilësore. AKAFPK-ja ka mbajtur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me secilin nga 44 ofruesit e AFP-ve, ku secilit prej ofruesve i është komunikuar progresi i arritur si dhe është diskutuar për të metat apo mangësitë që kanë patur.

Raporti ka marrë në konsideratë në mënyrë të përmbledhur të gjitha nënfushat e të pesë fushave të cilësisë që përdor instrumenti i vetëvlerësimit, për të matur ecurinë e cilësisë së ofruesit të AFP-së. Çdo nënfushë ndahet në dy pjesë ku në pjesën e parë renditet rezultati që është arritur kurse në pjesën e dytë vihet në dukje dobësitë që janë evidentuar. Në vijim janë paraqitur rezultatet sasiore për secilin prej ofruesve të AFP-së si dhe analiza e nënfushave nëpërmjet analizës së rezultateve në formë grafike.

Në përmbledhjen e raportit, janë formuluar rekomandimet përkatëse për çështjet që duhen përmirësuar në të ardhmen.

FUSHA 1 – MENAXHIMI

Fusha "Menaxhimi dhe Drejtimi" është një dimension shumë i rëndësishëm, efikasiteti dhe realizimi i kërkesave të kësaj fushe, paracakton qëndrueshmërinë dhe cilësinë e një ofruesi të AFP-së. Në këtë fushë evidentohet nëse ofruesit e AFP-së kanë një bashkëpunim dhe gjithëpërfshirje të të gjithë aktorëve, kanë bërë planifikime strategjike dhe vlerësime objektive, përdorin me efikasitet burimet njerëzore dhe materiale që kanë në dispozicion.

Fusha 1 “Menaxhimi dhe Drejtimi” është i përbërë nga nëntë nënfusha si më poshtë:

1. Gjithëpërfshirja
2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së
3. Plani vjetor i ofruesve të AFP-së
4. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore
5. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional
6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve
7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së
8. Zhvillimi profesional i stafit
9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

1. Gjithëpërfshirja

a. Rezultati

Është evidente që ofruesit e AFP-së realizojnë menaxhimin e tyre nëpërmjet ngritjes së organizmave zyrtare, si: Bordi i IoAFP-së, Këshilli i mësuesve, Qeveria e nxënësve, Këshilli i prindërve të IoAFP-së, Këshilli i Prindërve të Klasës, Komisioni i Disiplinës, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes. Të gjithë organizmat janë ngritur konform kërkesave ligjore, aktorët e interesuar janë të përfshirë si dhe ka një përhapje të kulturës së punës në grup.

b. Dobësitë

Përfshirja e prindërve në çështjet dhe organet e ofruesve vazhdon të jetë në nivel jo të kënaqshëm për arsye emigrimi, distancës fizike, mungesës së interesit dhe pengesa të tjera. Në disa raste haset në mungesë dokumentimi të veprimtarisë së organizmave të ofruesve, pasi ka mungesë të planeve të punës për disa prej tyre.

2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

Në përgjithësi plani afatmesëm është hartuar sipas formatit të rekomanduar dhe zbatohet nga ofruesit me përgjegjësi në mënyrë që të garantohet përmirësimi dhe progresi.

b. Dobësitë

Pesë nga ofruesit e kanë vlerësuar veten dobët, pasi kanë pasur mungesë të planit afatmesëm që vjen për shkak të mungesës së miratimit nga institucioni epror nga ku varet, ose ka qenë në proces përpunimi.

3. Plan i vjetor i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

Planet vjetore janë hartuar nga ofruesit e AFP-së duke respektuar të gjitha kërkesat ligjore. Këto plane janë miratuar nga Bordet e ofruesve, janë të zbatueshme dhe në përgjithësi zbërthejnë objektivat e planeve afatmesme.

b. Dobësitë

Disa nga ofruesit e AFP-së gjenden në vështirësi për të qasur grupet e interesit në hartimin e planit vjetor. Gjithashtu ofruesit gjatë hartimit të planit vjetor, hasin probleme në përfshirjen apo pasqyrimin qartë të veprimtarive me aspekte gjinore.

4. Plan i vëzhgimit të orëve mësimore

a. Rezultati

Drejtoritë e ofruesve të AFP-së zbatojnë planin e vëzhgimit të orëve mësimore. Mbahen shënime gjatë vlerësimit të tyre dhe gjetjet mundësojnë nxitjen e progresit të nxënësve/kursantëve si dhe vlerësimin e performancës të mësimdhënësve.

b. Dobësitë

Nga raportet e vetëvlerësimit evidentohet se Drejtuesit e ofruesve të AFP-së nuk kanë zhvilluar miniteste dhe provime në masën e dëshiruar për të evidentuar progresin e nxënësve/kursantëve. Kjo dukuri është shfaqur kryesisht për shkak të pandemisë apo mungesës së planifikimit. Gjithashtu, mangësi vërehet në bashkëpunimin e drejtuesve të ofruesve të AFP-së me mësimdhënësit përsa i përket analizës për gjetjet e orëve të vëzhguara, në disa raste kjo analizë është kryer, por vetëm verbalisht dhe nuk është dokumentuar.

5. Plan i monitorimit të dokumentacionit institucional

a. Rezultati

Nënfusha e pestë konsiston në planin e monitorimit të dokumentacionit institucional konform rregullave ligjore, e cila përfshin vëzhgimin dhe plotësimin e dokumentacionit zyrtar nga ofruesit e AFP-së.

b. Dobësitë

Në përgjithësi ofruesit e AFP-ve nuk shfaqin dobësi në këtë dimension.

6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve/kursantëve

a. Rezultati

Kjo nënfushë përfshin procedurën e regjistrimit të nxënësve, zbatimin e procedurave për transferim, ruajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit sipas kërkesave të legjislacionit. Përgjithësisht kërkesat për këtë nënfushë zbatohen rregullisht prej ofruesve të AFP-së.

b. Dobësitë

Nuk janë vërejtur dobësi në këtë nënfushë.

7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

Vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së tashmë është një procedurë e njohur dhe e mirë administruar prej tyre. Ekipet dhe stafet mësimore kanë shtuar bashkëpunimin dhe janë ndërgjegjësuar për impaktin e këtij detyrimi.

b. Dobësitë

Një pjesë e konsiderueshme e ofruesve të AFP-së nuk publikojnë raportin vjetor të vetëvlerësimit, të miratuar nga Bordi, në faqen e tyre të internetit.

8. Zhvillimi profesional i stafit

a. Rezultati

Ngritja e kapaciteteve të stafit është një element me rëndësi për mbarëvajtjen e proceseve mësimore dhe administrative. Ofruesit e AFP-së realizojnë planifikimin për trajnimin e stafit, i mbështesin për kualifikime të mëtejshme dhe shfrytëzojnë mundësitë e tyre për të bërë kërkesa për zhvillimin e mëtejshëm profesional të stafit.

b. Dobësitë

Ekzistojnë raste ku nevojat për trajnim të mësuesve nuk janë të identifikuar, ose janë identifikuar por nuk janë realizuar për shkak të pamundësive të ndryshme si rasti i pandemisë.

9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare


a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së realizojnë me efikasitet menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare. Ofruesit identifikojnë nevojat e tyre për personel mësimor, përcaktojnë dhe ndajnë qartë detyrat për personelin, mundësojnë bashkëpunimin midis stafit mësimor me stafin mbështetës, menaxhojnë buxhetin e miratuar sipas programit dhe në mbështetje të ligjeve.


b. Dobësitë

Nuk janë evidentuar mangësi në këtë nënfushë.


Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë:



Më poshtë paraqitet në formë grafike rezultati i nënfushave të Fushës 1 “Menaxhimi dhe Drejtimi”.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën 1 “Menaxhimi dhe Drejtimi” ka rezultuar se 17 prej tyre e shohin veten “Shumë mirë” në këtë fushë, 27 prej tyre e shohin veten “Mirë”, ndërkohë asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar veten “Mjaftueshëm” ose “Dobët”. Të dhënat janë paraqitur në grafikun më poshtë:



FUSHA 2 – MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI

Fusha e dytë e vetëvlerësimit “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi” udhëzon ofruesin e AFP-së të krijojë marrëdhënie bashkëpunuese me institucione, biznese, komunitetin, OJF, institucione homologe, institucione të arsimit post sekondar dhe atij të lartë, për funksionim efikas dhe materializimin e synimeve zyrtare. Objektivat thelbësorë që pritet të përmbushen nga këto bashkëpunime janë punësimi i nxënësve/kursantëve, bashkëveprimi me komunitetin dhe kontributi i tij për të mbështetur ofruesin, rritja e besueshmërisë ndaj ofruesit të AFP-së, promovimi dhe rritja e numrit të nxënësve/kursantëve, shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave të mira për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen e vazhdueshme të nivelit. Nëpërmjet kryerjes së vetëvlerësimit ofruesit e AFP-së i shpaloset qartë panorama e sukseseve dhe elementeve që janë ende të parealizuar plotësisht.

Fusha 2 përbëhet nga katër nënfushat si më poshtë:

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore.
2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin.
3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin.
4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve.

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore

a. Rezultati

Ofruesit zhvillojnë marrëdhënie dhe bashkëpunime institucionale të rregullta me institucionet qendrore, rajonale dhe vendore. Kjo nënfushë tregon një rritje të bashkëveprimit midis ofruesve të AFP-së dhe organeve qeveritare për sa i përket komunikimit zyrtar, zbatimit të udhëzimeve, përcjelljes së informacionit zyrtar, pjesëmarrjes në aktivitete dhe takime si dhe dokumentimit të këtyre marrëdhënieve. Ofruesit e AFP-së kërkojnë mbështetje zyrtare për bursat, apo për nxënësit me nevoja të veçanta, apo vështirësi të theksuara sociale.

b. Dobësitë

Marrëdhëniet me qeverisjen vendore vërehet se duhet të konsolidohen edhe më tepër, pasi ftesat për aktivitete dhe takime nuk janë të ndërsjella, për më tepër ka prirje që këto ftesa të bëhen në rrugë jo zyrtare nga ana e ofruesve të AFP-së. Gjithashtu është konstatuar një mungesë e zbatimit të veprimtarive me aspekte gjinore në bashkëpunim me pushtetin lokal.

2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin

a. Rezultati

Përgjithësisht vihet re se ka marrëdhënie dhe bashkëpunim midis ofruesve të AFP-së dhe bizneseve. Ofruesit e AFP-së disponojnë baza të dhënash për bizneset në rajonet përkatëse. Kanë bashkëveprim të rregullt me bizneset duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi si dhe duke zhvilluar praktikat profesionale në mjediset e tyre në bazë të kontratës zyrtare, tip. Njësia e Zhvillimit është e pranishme kurdoherë për të ndjekur dhe për të shtyrë më tej mbarëvajtjen e marrëdhënieve me këto biznese.

b. Dobësitë

Nga raportet e ofruesve të AFP-së konstatohet se bizneset nuk janë plotësisht të gatshëm për të bashkëpunuar, disa ofrues ende nuk kanë identifikuar plotësisht bizneset që veprojnë në rajonin e tyre si dhe nuk mirëmbajnë bazën e të dhënave dhe komunikimit me to. Për më tepër ekzistojnë raste ku ofruesit nuk kanë një marrëveshje bashkëpunimi të konfirmuar sipas kërkesave ligjore. Më tej konstatohet mungesa e kryerjes së analizës periodike të tregut nga ofruesit e AFP-së, si dhe planifikimi i veprimtarive me aspekte gjinore.

3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin

a. Rezultati

Mbeten ende pa progres marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile. Ofruesi kanë arritur në krijimin e një plani të përfshirjes së prindërve në jetën institucionale, ata janë të përfaqësuar në organizmat vendimmarrës, gjithashtu ka një komunikim të vazhdueshëm dhe të rregullt për sa i përket mbarëvajtjes së shkollës dhe për ecurinë dhe progresin e nxënësve. Të paktë janë ofruesit që disponojnë të dhëna për OJF-të; rastet të cilat kanë hartuar projekte zhvillimore dhe kanë fituar mbështetjen e OJF-ve janë sporadike.

b. Dobësitë

Ashtu sikurse evidentohet nga pohimet e ofruesve të AFP-se, janë hedhur hapa pozitive për përfshirjen e prindërve në proceset institucionale, megjithatë ka pamjaftueshmëri në pjesëmarrjen dhe aktivizimin gjithëpërfshirës të prindërve dhe kjo vjen si pasojë e problematikave socio-ekonomike. Ofruesit e AFP-së gjithashtu e kanë të vështirë të përmbushin standardet për tu kthyer në qendra komunitare, ato ofrojnë për komunitetin më së shpeshti ambientet e jashtme dhe më rrallë materialet që zotërojnë. Pikë e dobët ngelet bashkëpunimi me shoqërinë civile, pjesa më e madhe e ofruesve nuk zotërojnë një bazë të dhënash ku të jenë identifikuar OJF-të. Vërehet se ofruesit e AFP-së thajse nuk kanë njohuri dhe kapacitete për të hartuar projekte zhvillimore; ato zbatojnë vetëm projekte të propozuara nga donatorë të ndryshëm dhe OJF. Për më tepër ofruesit e AFP-së nuk zbatojnë veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me komunitetin apo shoqërinë civile.

4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve


a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së kanë të identifikuar institucionet homologe dhe deri diku ka një bashkëpunim për zhvillimin e përbashkët profesional. Disa nga këta ofrues kanë arritur të krijojnë binjakëzime me institucione homologe jashtë vendit. Ofruesit e AFP-së ndjekin dhe zbatojnë me rregullsi planin e tyre të promovimit për të realizuar një nga objektivat e tyre kryesore rritjen e numrit të nxënësve/kursantëve në AFP. Aplikojnë veprimtari dhe aktivitete të ndryshme për këshillimin e karrierës, ditët e hapura për informim, panaire dhe promovim në rrjete sociale. Vërehen disa bashkëpunime me institucione të arsimit të lartë por nuk qëndrojnë në nivelin e dëshiruar.


b. Dobësitë

Përpos dëshirës së mirë të ofruesve të AFP-së për të krijuar binjakëzime me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit ende nuk vihet re përmirësim. Gjithashtu marrëdhëniet e ofruesve me institucione të arsimit post sekondar dhe atij të lartë për zhvillimin profesional të mëtijshëm hasin ende në mangësi në rritjen e numrit të këtyre bashkëpunimeve si dhe në mungesën e dokumentimit dhe komunikimit në formë zyrtare.


Në formë grafike rezultati i fushës për 44 ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë.



Grafiku i mëposhtëm tregon vlerësimin e nënfushave për ofruesit e AFP-së për fushën 2 “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi”.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi” ka rezultuar se 7 prej tyre e shohin vetën “Shumë mirë” në këtë fushë, 32 prej tyre e shohin vetën “Mirë”, 5 prej tyre e shohin vetën “Mjaftueshëm”, ndërkohë asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar vetën “Dobët”. Të dhënat janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



FUSHA 3-KURRIKULA E ZBATUAR

Kjo fushë lidhet me zhvillimin e kurrikulës së ofruesit të AFP-së në përputhje me standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve profesionale brenda autonomisë së ofruesit të AFP-

së për hartimin dhe zbatimin e saj në nivel ofruesi si dhe mundëson formimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave profesionale.

Fusha 3 përbëhet nga pesë nënfushat si më poshtë:

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së
2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së
3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm
4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës
5. Ekipi kurrikular

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së hartojnë planin e zhvillimit të orëve mësimore dhe programet e mësimdhënies teorike dhe praktike profesionale në përputhje me kërkesat e përcaktuara në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale. Gjithashtu edhe planifikimi dhe shpërndarja e orëve bëhet sipas kërkesave të skeletkurrikulave. Programet e mësimdhënies zbatohen vetëm pasi marrin miratimin e drejtorit të ofruesit të AFP-së. Disa ofrues kanë raportuar se pavarësisht autonomisë së tyre në hartimin e planeve mësimore dhe përshtatjes së tyre me mundësitë e praktikave profesionale të nxënësve në ofrues dhe në biznese, respektohen udhëzimet përkatëse.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit nuk është evidentuar ndonjë dobësi lidhur me plotësimin e kësaj nënfushe.

2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së

a. Rezultati

Shkollat dhe Qendrat e Formimit Profesional të cilat ofrojnë programe kursesh, i zhvillojnë ato konform kërkesave të dokumentave zyrtare duke respektuar kërkesat e programit të kurseve në përputhje me skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale të cilat aksesohen nga faqja zyrtare e AKAFPK-së. Një pikë tjetër e fortë e kësaj nënfushe lidhet me planifikimin e kurrikulave në nivel ofruesi duke marrë në konsideratë nevojat lokale dhe rajonale të tregut të punës, por kjo nuk është e pranishme tek të gjithë ofruesit (kryesisht QFP). Plani i zhvillimit të kurseve punohet dhe kontrollohet nga koordinatori i NJZH, dhe vetëm pas miratimit të drejtorit, plani vihet në praktikë. Ky plan mund të rishikohet gjatë zhvillimit të kursit sipas nevojave, por gjithmonë pasi miratohet nga drejtorit i ofruesi të AFP-së.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit ka QFP të cilat kanë raportuar për dobësi në lidhje me kurrikulën që kanë të bëjnë me mos dokumentimin në mënyrë korrekte, identifikimin e nevojave të tregut lokal dhe rajonal për kurset afatshkurtra. Ka QFP të cilat kanë raportuar se nuk është zhvilluar ndonjë analizë e mirëfilltë mbi nevojat e tregut lokal dhe rajonal të punës dhe kryesisht nevojat janë matur me kërkesat që vijnë drejtë për drejtë nga grupet e interesit dhe me frekuentimin e kurseve në qendrat e formimit profesional.

3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm

a. Rezultati

Nga analiza e raporteve u arrit në konkluzionin se planet vjetore lëndore hartohen në përputhje me kërkesat zyrtare të dokumenteve kurrikulare, pasi janë edhe detyrim ligjor. Planet vjetore ndahen në plane tremujore dhe përmbajnë objektiva dhe rezultatet e të nxënës, të përshtatura me nivelin e nxënësve si dhe metodologjinë e mësimdhënies dhe të vlerësimit. Për nxënësit me rezultate të dobëta hartohet një plan plotësues. Mësimdhënësit i përfshijnë nxënësit edhe në detyra të pavarura dhe projekte kurrikulare, të cilat përfshijnë edhe aspekte gjinore në disa ofrues. Në planet ditore mësuesit paraqesin edhe lidhjet ndër lëndore. Lidhur me projektet kurrikulare, ofruesit e AFP-së kanë raportuar se këto projekte përmbajnë disa nga rubrikat e kërkuara. Projektet kurrikulare vlerësohen me notë duke u bazuar në kritere zyrtare. Nga të dhënat ka rezultuar se disa ofrues hartojnë edhe plane mësimore të diferencuara të përshtatura për nxënësit me nevoja të veçanta.

b. Dobësitë

Lidhur me dobësitë e kësaj nënfushe, analiza e raporteve ka treguar se në shumë ofrues mungojnë dosjet e projekteve kurrikulare ose nuk hartohet raporti përfundimtar i projektit. Planet ditore nuk përmbajnë mjaftueshëm elementë të barazisë gjinore. Prindërit nuk bashkëpunojnë me mësimdhënësit dhe nxënësit për projektet kurrikulare dhe kjo mund të jetë edhe rrjedhojë e nivelit të ulët social-ekonomik, sipas të dhënave të vetëvlerësimit. Planet mësimore të diferencuara për nxënësit me nevoja të veçanta mbeten ende një ndër pikat e dobëta në ofruesit e AFP-së, pasi nuk kanë mësues ndihmës. Ndërsa mos planifikimi i detyrave të shtëpisë dhe detyrave në grup, është një çështje e evidentuar por jo e pranishme në shumicën e ofruesve, për ta konsideruar si pikë të dobët në nivel kombëtar.

4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

a. Rezultati

Tekstet e formimit profesional sigurohen nga vetë shkolla dhe mësimdhënësit janë pjesë e procedurës për përzgjedhjen e teksteve ndërsa procesi i altertektstit dhe përzgjedhja e teksteve të kulturës së përgjithshme sigurohet nga orientimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu ndihmojnë edhe portalet online p.sh. *mesovet.al*. Mjetet mësimore krijohen nga vetë mësimdhënësit ose së bashku me nxënësit. Këto mjete janë në përputhje me objektivat e

përcaktuara në plane mësimore. Pjesa më e madhe e ofruesve janë të pajisur me laboratorë dhe mjedise të edukimit fizik të cilat ndihmojnë në zbatimin e kurrikulës. Kushtet higjeno-sanitare janë të përshtatshme, dhe duke qenë se viti shkollor 2020-2021 ka qenë ende nën ndikimin e pandemisë Covid-19, ofruesit kanë marrë masat e duhura mbrojtëse gjatë realizimit të mësimdhënies.

b. Dobësitë

Nga dobësitë e konstatuara në analizën e raporteve të vetëvlerësimit, mungesa e teksteve profesionale mbetet ende një dobësi në sistemin e AFP-së. Ka edhe mungesë në mjetet materiale të nevojshme në zbatimin e kurrikulës. Gjithashtu në disa prej ofruesve mungojnë plotësisht laboratorët për lëndët e kulturës së përgjithshme, laboratorë TIK dhe ambiente të edukimit fizik. Prindërit nuk bashkëpunojnë me mësimdhënësit dhe nxënësit në krijimin e mjeteve mësimore, dhe në disa raste nuk janë bërë përpjekje për aplikimin e kësaj praktike.

5. Ekipi kurrikular


a. Rezultati

Në ofruesit e AFP-së të cilët e kanë ngritur ekipin kurrikular konform akteve ligjore, është arritur në përfundimin se përgjithësisht ekipi kurrikular fton në mbledhjet e tij përfaqësues të bordit të shkollës, qeverisë së nxënësve dhe këshillit të prindërve të shkollës. Gjithashtu ofruesit e respektojnë autonominë e vet në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës.


b. Dobësitë

Pikat e dobëta në funksionimin e kësaj nënfushë kanë të bëjnë me faktin se nuk ka përfaqësues të Bordit në ekipet kurrikulare të të gjithë ofruesit, ndërsa prindërit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet që organizon ekipi kurrikular, por ata nuk paraqiten. Ka edhe ofrues të cilat kanë raportuar se në mbledhjet e ekipit kurrikular nuk ftohen anëtarë të Bordit të shkollës, qeverisë së nxënësve dhe këshillit të prindërve të shkollës. Një tjetër pikë e dobët lidhur me ekipin kurrikular është se pavarësisht se ky organ është ngritur konform akteve ligjore, veprimtaria e tij nuk dokumentohet dhe bashkëpunimi midis anëtarëve të ekipit kurrikular nuk është në nivelin e duhur.


Më poshtë paraqitet rezultati i fushës për 44 ofruesit publikë të AFP-së.



Grafiku i mëposhtëm tregon vlerësimin e nënfushave për ofruesit e AFP-së për fushën 3: Kurrikula e zbatuar.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën 3: “Kurrikula e zbatuar”, është arritur në përfundimin se 17 ofrues publikë të AFP-së, e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë”, 26 prej tyre e kanë vlerësuar vetën “Mirë”, 1 prej tyre e ka vlerësuar vetën “Mjaftueshëm”. Nuk ka asnjë ofrues AFP-je që e ka vlerësuar vetën “Dobët”.



FUSHA 4 –MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Kjo fushë lidhet me dy procese thelbësore të cilat synojnë përvetësimin e njohurive, shprehive dhe kompetencave kyçe dhe profesionale të nxënësit/kursantët në përmbushje të kërkesave të standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve profesionale.

Fusha 4 përbëhet nga njëmbëdhjetë nënfushat si më poshtë:

- 1.Plani ditor
- 2.Rezultatet mësimore
- 3.Parimet kryesore gjatë orës së mësimi
- 4.Ana Shkencore
- 5.Baza materiale dhe didaktike
6. Mjedis fizik
- 7.Metodologjia
- 8.Detyrat e shtëpisë
- 9.Përsëritja
- 10.Mjedis i sigurt për të nxënësit
- 11.Nxënësit dhe kursanti me nevoja të veçanta

1. Plani ditor

a. Rezultati

Mësimdhënësit hartojnë planet ditore mbështetur në planet vjetore për lëndët e formimit të përgjithshëm, lëndët e kulturës profesionale dhe modulet praktike. Mësimdhënësit shfrytëzojnë lirinë profesionale në hartimin e planeve ditore dhe gjithashtu mbështeten edhe në modele mësimore të njohura, në formate të rekomanduara dhe në dispozitat normative. Planifikimi i orëve mësimore paraqitet sipas një strukture të përcaktuar ku elementët që përdoren gjithmonë janë tema, rezultatet e të nxënës dhe plani i orëve mësimore.

b. Dobësitë

Lidhur me këtë nënfushë është arritur në konkluzionin se jo të gjithë mësimdhënësit përfshijnë në planet ditore veprimtari për nxënësit me nevoja të veçanta, dhe nuk planifikohen aspektet gjinore. Nuk mbahen gjithmonë të dhëna për nxënësit me vështirësi në të nxënë. Gjithashtu pjesa më e madhe e ofruesve nuk përfshijnë rubrikën “*Refleksione*” në planet ditore. Koha për secilën veprimtari në plane mësimore nuk përcaktohet nga shumica e ofruesve. Në ofruesit e AFP-së të cilët e përcaktojnë kohën e veprimtarive që do të realizohen gjatë orës mësimore kanë raportuar se nuk respektohet koha për arsye të ndryshme si specifikat e orëve mësimore, reagimit të nxënësve, nivelit të tyre.

2. Rezultatet mësimore

a. Rezultati

Nga analiza e nënfushës është arritur në konkluzionin se plani mësimor i hartuar mundëson arritjen e rezultateve mësimore, të cilat formulohen në përputhje me kurrikulën dhe paraqiten në planin ditor se çfarë pritet të përvetësojnë nxënësit në fund të orës mësimore. Mësimdhënësit zbatojnë forma dhe lloje të ndryshme të metodave dhe instrumenteve për matjen e rezultateve të tilla si pyetje nga mësimdhënësi, pyetje nga nxënësi, mini teste apo mini konkurse. Duke marrë në konsideratë nivelin e nxënësve të klasës, mësimdhënësit nuk përcaktojnë RN në të tri nivelet e të nxënës, por vetëm në dy nivelet e para, i ulët dhe mesatar.

b. Dobësitë

Ndër dobësitë më të shpeshta, të cilat janë evidentuar lidhur me nënfushën e rezultateve mësimore lidhen pikë së pari me elementin e kohës. Ka raste kur koha nuk është përcaktuar për veprimtaritë mësimore por ka edhe ofrues të cilët kanë treguar se koha e përcaktuar për veprimtaritë mësimore nuk zbatohet me rigorozitet. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme të tilla si; nevoja për më tepër sqarime të detajuara për nxënësit kur ata kryejnë detyra të pavarura, specifikave të orës mësimore, dhe mundësisë së tyre për të realizuar veprimtaritë e planifikuara. Një shkak tjetër lidhet edhe me pandeminë dhe organizimin e mësimi on-line. Është konstatuar mos arritja e nivelit mesatar dhe të lartë të rezultateve mësimore, kjo si pasojë e

faktorëve që lidhen me nxënësit si mungesa e përqendrimit dhe dëshirës së tyre, por edhe si pasojë e mungesës së bazës materiale dhe didaktike. Nevojitet të punohet më shumë nga ofruesit e AFP-së në këtë drejtim për të gjetur forma dhe metoda më të larmishme për të nxitur pjesëmarrjen e nxënësve në orët mësimore, si dhe më tepër përpjekje për sigurimin e bazës materiale dhe didaktike, e cila do të analizohet më poshtë me nënfushë të veçantë. Në pak ofrues përcaktohen të dyja llojet e rezultateve të të nxënësve; rezultate të programit mësimor dhe rezultate të orës mësimore. Së fundi, nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit është arritur në përfundimin se nuk zhvillohen mjaftueshëm teste për matjen e rezultateve të të nxënësve.

3. Parimet kryesore gjatë orës së mësimi

a. Rezultati

Nga analiza e nënfushës ka rezultuar se në përgjithësi, në rreth gjysmën e ofruesve të AFP-së, mësimdhënësit përpiqen t'i kushtojnë një rol thelbësor përvetësimit të koncepteve dhe aftësive themelore të lëndës/modulit/kursit si dhe zbulimit të lidhjeve midis lëndëve të ndryshme brenda një klase ose midis klasave të mëparshme. Nxënësit nxiten që të zbulohen lidhjet ndër kurrikulare nëpërmjet metodave të tilla si debati, punët individuale dhe në grup, lidhja e njohurive të marra me përvojat personale dhe situatat e jetës së përditshme, shembuj nga praktika në biznes etj. Të gjithë nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë nga mësimdhënësit gjatë ndarjes dhe dhënies së detyrave.

b. Dobësitë

Përpos pikave të forta të përmendura më sipër, nuk mund të lihen pa anashkaluar edhe disa pika të dobëta të evidentuara nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit. Në disa ofrues, nevojitet më tepër punë nga mësimdhënësit lidhur me përvetësimin e koncepteve kryesore dhe zbulimin e lidhjes midis tyre, dhe ristrukturimin e koncepteve të sapo mësuara me kapitujt e mëparshëm dhe njohuritë e fituara në klasat e mëparshme. Kjo teknikë duhet të realizohet rregullisht nga të gjithë mësimdhënësit jo vetëm të lëndëve të kulturës së përgjithshme por edhe ata të kulturës profesionale pasi këta të fundit e kanë më të vështirë të dalin nga metoda tradicionale e mësimdhënies duke u mbështetur në shtjellimin vetëm teorik të lëndës.

4. Ana Shkencore

a. Rezultati

Nga analiza e nënfushës rezulton se në më shumë se gjysmën e ofruesve publikë të AFP-së, mësimdhënësit zotërojnë anën shkencore, kanë aftësitë e duhura për të zhvilluar lëndën dhe modulet përkatëse si dhe zotërojnë shumë mirë konceptet themelore të lëndës. Mësimdhënësit bëjnë përpjekje edhe nga ana e tyre për zhvillimin profesional.

b. Dobësitë

Pavarësisht faktit se kjo nënfushë nuk ka patur problematika të theksuara, në një numër të vogël të ofruesve publikë të AFP-së janë evidentuar disa problematika lidhur me mos marrjen në konsideratë të trajtimit të situatave ndër kurrikulare nga ana e mësimeve, mospasjen e njohurive të domosdoshme në fushën e teknologjisë së informacionit për ta vënë në zbatim gjatë procesit mësimor, si dhe me mosnjohjen e metodave bashkëkohore të mësimit. Gjithashtu nevojitet që mësimit të zgjerohet njohuritë e tyre në kërkime shkencore. Theksohet se këto problematika janë evidentuar vetëm në disa ofrues, të cilët duhet të marrin masa për trajnimin e mësimeve për një mbarrëvajtje më të kënaqshme të procesit mësimor.

5. Baza materiale dhe didaktike

a. Rezultati

Rezultatet e analizës së raporteve treguan se në rreth gjysmën e ofruesve publikë të AFP-së, baza materiale dhe didaktike është në nivel të mjaftueshëm për t'u përdorur gjatë orëve mësimore. Mësimit bëjnë përpjekje të përgatitin vetë mjetet mësimore, ose sigurojnë pajisjet TIK nga ana e tyre për të ndihmuar në procesin mësimor. Lidhur me bashkëpunimin në sigurimin e mjeteve mësimore, mësimit bashkëpunojnë më shpesh me nxënësit, duke e përdorur këtë ndërveprim edhe si një formë motivimi për ta. Gjithashtu disa ofrues kanë pohuar se materialet mësimore të publikuara në faqen zyrtare të AKAFPK i kanë ndihmuar në zhvillimin e orëve mësimore.

b. Dobësitë

Janë evidentuar disa problematika lidhur me sigurimin dhe përdorimin e bazës materiale dhe didaktike gjatë zhvillimit të orëve mësimore dhe praktikave. Rreth gjysmës së ofruesve të AFP-së kanë mungesa në bazën materiale, ose burimet ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë nxënësit dhe kjo është më e dukshme në lëndët e kulturës profesionale. Gjithashtu nevojitet shtimi i pajisjeve të teknologjisë së informacionit si një mjet i domosdoshëm dhe bashkëkohor për zhvillimin e orëve mësimore. Mungon bashkëpunimi i mësimeve me prindërit dhe komunitetin për të ndihmuar në sigurimin e mjeteve mësimore.

6. Mjedisi fizik

a. Rezultati

Në përgjithësi, kjo nënfushë nuk ka patur problematika të theksuara në nivel kombëtar. Mjedisi fizik i klasave është i përshtatshëm për zhvillimin e orëve mësimore, pasi ambientet janë të mirëmbajtura edhe nga stafi përgjegjës. Nxënësit kanë mundësi të organizohen në klasa për të zhvilluar punë në grupe si dhe ka hapësira të mjaftueshme për krijimin e ekspozitave me punët individuale ose në grup të nxënësve.

b. Dobësitë

Janë evidentuar disa pika të dobëta, në një numër shumë të vogël ofruesish publikë të cilat kanë të bëjnë me domosdoshmërinë e rikonstruksionit dhe restaurimit të ambienteve të ofruesve dhe me numrin jo të mjaftueshëm të klasave në përputhje me numrin e nxënësve (arsye e cila ka bërë që mësimi të zhvillohet me dy turne), me lirshmërinë e kufizuar të nxënësve dhe detyrimin për të lëvizur nga një godinë e ofruesit në godinën tjetër për zhvillimin e orës mësimore të TIK (kjo e fundit e evidentuar vetëm në një prej ofruesve të AFP-së).

7. Metodologjia

a. Rezultati

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit, për këtë nënfushë ka rezultuar që përgjithësisht mësimdhënësit përdorin teknika të punës në grup dhe të punës individuale të planifikuara për zhvillimin e orëve mësimore. Disa prej metodave janë: refleksioni dhe diskutimet mësimdhënësnxënës. Në disa ofrues zhvillohen edhe orë të hapura me pjesëmarrjen e kolegëve dhe prindërve, por gjatë periudhës së pandemisë mundësia për të realizuar orët e hapura ka qenë e kufizuar.

b. Dobësitë

Metodat, teknikat dhe strategjitë mësimore duhet të jenë të lidhura ngushtësisht me rezultatet e të nxënësve dhe objektivat. Ka ende disa ofrues në të cilët është evidentuar se puna në grup e nxënësve nuk është një metodë që përdoret shpesh, dhe si rrjedhojë nxënësve nuk i kanë të zhvilluara aftësitë e të punuarit në grup dhe rolin e tyre. Nevojiten më shumë trajnime për mësimdhënësit, në veçanti për mësimdhënësit e kulturës profesionale për të përdorur metoda më të larmishme gjatë zhvillimit të orëve mësimore.

8. Detyrat e shtëpisë

a. Rezultati

Nga analiza e rezultateve të raporteve të vetëvlerësimit për nënfushën e detyrave të shtëpisë është konstatuar se përgjithësisht mësimdhënësit japin detyra shtëpie dhe kontrollohen rregullisht nga mësimdhënësit.

b. Dobësitë

Dobësitë e evidentuara për këtë nënfushë lidhen me faktin se detyrat jepen të njëjta për të gjithë nxënësve duke mos marrë në konsideratë të tre shkallët e vështirësive, përdorimin e kërkesave të TIK-ut dhe situata e çështje që lidhen me edukimin gjinor. Një çështje tjetër e evidentuar është se jo të gjithë ofruesit e AFP-së japin detyra shtëpie, të cilat lidhen me zbatimin e tyre në botën reale. Detyrat e shtëpisë jepen nga mësimdhënësit pa u dhënë mundësinë nxënësve të vendosin vetë për llojin e detyrave të shtëpisë.

9. Përsëritja

a. Rezultati

Mësimdhënësit realizojnë orë të përsëritjes edhe për orën mësimore, në fund të kapitullit ose kapitujve ose përsëritje për modulet praktike. Përsëritjet janë të planifikuara në planet vjetore mësimore. Orët përsëritëse zhvillohen nëpërmjet metodave të ndryshme si testime me shkrim për lëndë/module, testime me short, detyra, përsëritje individuale, në grup ose në formën e një konkursi.

b. Dobësitë

Një nga pikat e dobëta e konstatuar për këtë nënfushë është se gjatë zhvillimit të përsëritjes duhet të kushtohet më tepër vëmendje në zbulimin e lidhjes së kapitujve me njëri tjetrin, brenda së njëjtës lëndë ose zbulimit të lidhjeve të njohurive me njohuritë e marra në lëndë të tjera, ose me njohuritë e marra në klasat paraardhëse.

10. Mjedis i sigurt për të nxënëit

a. Rezultati

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit është arritur në konkluzionin se nuk ka problematika për ti përgjithësuar në nivel kombëtar. Ofruesit e AFP-së bëjnë vazhdimisht përpjekje për të krijuar një mjedis pozitiv në klasa dhe në mjediset e praktikës profesionale. Nxënësit ndihen të lirshëm për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre si dhe për të bashkëvepruar me nxënësit e tjerë në mjediset mësimore. Përgjithësisht konfliktet zgjidhen në mënyrë konstruktive dhe nuk ka patur raste të përdorimit të dhunës fizike apo verbale të nxënësit nga ana e mësimdhënësve. Në shkollat që kanë psikolog kërkohet edhe ndihma e tij për zgjedhjen e konflikteve. Nuk janë raportuar raste të thyerjes së disiplinës apo notës në sjellje.

b. Dobësitë

Të paktë janë ofruesit e AFP-së të cilët kanë raportuar pika që kanë nevojë për përmirësim lidhur me këtë nënfushë, por pavarësisht kësaj nuk mund të anashkalohen për nga rëndësia si: qortimi i nxënësve përpara klasës apo përdorimi i frazës “e ke gabim”, mos nxitja e mendimit të pavarur të nxënësit dhe konflikte midis nxënësve ku ofruesit kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për zgjidhjen e tyre.

11. Nxënësit dhe kursanti me nevoja të veçanta

a. Rezultati


Në të gjithë ofruesit e AFP-së janë identifikuar nxënësit me nevoja të veçanta ndërsa në disa prej ofruesve të AFP-së nuk ka nxënës me nevoja të veçanta. Mësimdhënësit përpiqen t'i lehtësojnë nxënësit me nevoja të veçanta, duke u dhënë detyra të përshtatura me nivelin e tyre si dhe i

lavdërojnë për arritjet e tyre. Ofruesit të cilët kanë mësues ndihmës ose psikolog në shkollë hartojnë programe edukative individuale për këta nxënës.


b. Dobësitë

Vazhdon ende që kjo nënfushë të ketë problematika, pasi janë shumë pak ofrues të cilët kanë psikolog shkolle dhe mësues ndihmës për hartimin e Programeve Edukative Individuale (PEI) për nxënësit me nevoja të veçanta. Mungojnë materialet mësimore mbështetëse të përshtatura për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Gjatë analizës së raporteve të vetëvlerësimit janë konstatuar edhe raste ku mungesa e infrastrukturës së përshtatshme në ofrues pengon nxënësit me aftësi të kufizuara lëvizore për tu ngjitur në katet me të larta të godinës së ofruesit.


Më poshtë paraqitet rezultati i fushës për 44 ofruesit publikë të AFP-së.



Grafiku i mëposhtëm tregon vlerësimin e nënfushave për ofruesit e AFP-së për fushën 4: “Mësimdhënia dhe të nxënit”.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën 4: “Mësimdhënia dhe të nxënit”, 10 ofrues të AFP-së e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë”, 32 ofrues e kanë vlerësuar veten “Mirë”, 2 ofrues e kanë vlerësuar veten “Mjaftueshëm”, dhe asnjë ofrues AFP-je nuk e ka vlerësuar veten “Dobët”.



FUSHA 5 – VLERËSIMI

Kjo fushë synon të stimulojë planifikimin e vlerësimit të vazhdueshëm dhe gjykit të mësimdhënësit ndaj nxënësit/kursantit duke ndjekur procedura korrekte si dhe teknika të larmishme vlerësimi. Kryesisht nëpërmjet procesit të vlerësimit mund të gjykohet mbi arritjet

dhe dobësitë e nxënësit/kursantit, si dhe mund të jepet motivim për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Kjo fushë përbëhet nga gjashtë nënfusha si më poshtë:

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit
2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit
3. Procesi i vlerësimit
4. Arritjet
5. Rivlerësimi
6. Ankimimet

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së tashmë kanë përvetësuar kërkesat për vlerësimin periodik të nxënësit/kursantit duke bërë që ky të jetë një proces standard dhe i rregullt. Mësuesit/instruktorët kanë një program vlerësimi të qartë, përdorin tre llojet e vlerësimit por me më tepër efikasitet vlerësimin e vazhduar me metoda të larmishme si dhe vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse sipas kërkesave të kompetencave të fushës dhe lëndës.

b. Dobësitë

Referuar raporteve të ofruesve të AFP-së konstatohet se ka një mungesë të theksuar të përdorimit të teknikës së “vetëvlerësimit të nxënësit” apo edhe të “vlerësimit të nxënësve nga nxënësit”. Për më tepër ka një mosfunksionim përsa i përket vlerësimit të portofolit dhe kjo rrjedh si pasojë e disa problematikave si: neglizhenca e vetë mësimdhënësve për ta shqyrtuar, niveli i ulët i nxënësve/kursantëve, jo të gjithë nxënësit/kursantët punojnë me portofolin, nuk krijohet një interaktivitet dhe dakordësi midis aktorëve përgjegjës për përzgjedhjen e përbashkët të rubrikave që do mbajë dosja/portofoli i nxënësit/kursantit.

2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Nxjerrja e rezultateve vjetore është një detyrë që mësuesit kryejnë në mënyrë të vazhdueshme në formë procedurale, pa vështirësi, në mënyrë korrekte dhe me vëmendjen e vetë drejtorive të ofruesve të AFP-së. Mësuesit kryejnë vlerësimin përfundimtar gjithmonë duke respektuar udhëzimet zyrtare, po ashtu duke ndjekur të njëjtën përpikmëri, ofruesit e AFP-së organizojnë dhe administrojnë provimet përfundimtare.

b. Dobësitë

Evidentohet në masë të madhe se në Komisionet e vlerësimit të praktikës profesionale nuk marrin pjesë aktorë të rëndësishëm për AFP-në siç janë përfaqësuesit e biznesit. Shumica e ofruesve të AFP-së njoftojnë përfaqësues të biznesit për të dhënë kontributin e tyre në këtë proces, mirëpo gjatë gjithë kohës hasin në indiferentizmin e tyre.

3. Procesi i vlerësimit

a. Rezultati

Nga raportet vërehet se shumica e mësuesve kanë një program të qartë dhe të plotë vlerësimi. Në këtë program përfshihen instrumente dhe teknika të ndryshme vlerësimi, si në vlerësimin e vazhduar apo vlerësimin përmbledhës. Vlerësimi është motivues, krijon interaktivitet dhe ngjall motivim tek nxënësit/kursantët, njëkohësisht parim i vlerësimit të tyre është vlerësimi i paanshëm dhe pa paragjykime gjinore. Për këtë qëllim mësuesit përdorin evidenca të ndryshme për të matur ecurinë e nxënësve/kursantëve.

b. Dobësitë

Nga pohimet e ofruesve të AFP-së vërehet se ka një mungesë të gjerë lidhur me qartësimin e prindërve për programin e vlerësimit, kjo rrjedh pjesërisht si pasojë e mungesës së interesit, ose nivelit të ulët arsimor, por gjithashtu ka dhe raste neglizhimi nga ana e mësuesve për ti qartësuar. Po ashtu ekzistojnë raste më sporadike ku mësuesit nuk tregojnë rregullsi në përdorimin e evidencave për pasqyrimin e vlerësimeve të nxënësve.

4. Arritjet

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së kryejnë analiza të shumëllojshme të arritjeve të nxënësve/kursantëve. Analizat përfshijnë në vetvete rezultatet e Provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe një analizë krahasuese me rezultatet e brendshme. Gjithashtu kryhen analiza për provimin e Teorisë profesionale të integruar, analizohen rezultatet e kursantëve në provimin përkatës të kurseve të unifikuara. Realizimi i procesit të provimeve përfundimtare ndjek udhëzimet përkatëse zyrtare. Më tej mësuesit raportojnë në mënyrë periodike tek prindërit me qëllim informimin e tyre për rezultatet e nxënësve.

b. Dobësitë

Është konstatuar se ka mospërputhje midis vlerësimit të brendshëm me vlerësimin e jashtëm; Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale e cila ka një luhajtje midis vlerësimeve. Evidentohen disa raste ku ofruesit e AFP-së nuk analizojnë përputhshmërinë e testeve të Provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale me programet e lëndëve përkatëse. Përsa i përket

përputhshmërisë së rezultateve të Provimeve Përfundimtare të niveleve, me vlerësimin e brendshëm të ofruesit të AFP-së dhe të përfaqësuesve të biznesit, nuk është e mundur gjithmonë një analizë e tillë, pasi këta të fundit mungojnë në Komisionet e vlerësimit. Për më tepër rezultatet e arritura të nxënësve/kursantëve nuk pasqyrohen gjithmonë sipas ndarjeve gjinore.

5. Rivlerësimi

a. Rezultati

Është një mekanizëm i mbështetur në kuadrin ligjor, i cili i ofron mundësinë nxënësve/kursantëve për t'u rivlerësuar dhe zbatohet në mënyrë korrekte kur është e nevojshme.

b. Dobësitë

Nuk janë evidentuar të meta dhe mangësi në zbatim të këtij procesi.

6. Ankimimet


a. Rezultati

Kjo nënfushë përfshin një procedurë të mbështetur në kuadrin ligjor, të rregullt dhe standarde, e cila krijon hapësirë për ankimim të vlerësimit të nxënësve/kursantëve dhe aplikohet nga ofruesit e AFP-së me përpikmëri duke respektuar afatet e caktuara ligjore.


b. Dobësitë

Nga raportet e ofruesve të AFP-së konstatohet se 4 prej këtyre institucioneve, ende nuk kanë një procedurë zyrtare për t'u përgjigjur ankimimeve të nxënësve për provimet përfundimtare.


Në formë grafike rezultati i fushës për 44 ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë.



Në grafikun e mëposhtëm paraqiten vlerësimet për secilën nga nënfushat e Fushës 5 “Vlerësimi”.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për Fushën 5 “Vlerësimi” ka rezultuar se 12 prej tyre e shohin veten “Shumë mirë” në këtë fushë, 32 prej tyre e shohin veten “Mirë”, ndërkohë asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar veten “Mjaftueshëm” ose “Dobët”. Të dhënat janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.




KONKLUZIONE

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit për periudhën 2020-2021 u ka shërbyer 44 ofruesve publikë të AFP-së për vlerësimin e performancës së tyre mbi bazën e pesë fushave të cilësisë. Sa më me objektivitet të vlerësohen kriteret e vetëvlerësimit, aq më e thjeshtë është për ofruesit e AFP-së të identifikojnë pikat e forta dhe pikat e dobëta në funksionimin e tyre. Të gjithë ofruesit e AFP-së kanë nxjerrë në pah pikat e forta dhe pikat që kanë nevojë për përmirësim, të cilat janë përpunuar nga AKAFPK për të nxjerrë përfundime në nivel kombëtar.

AKAFPK-ja ka patur një rol tepër aktiv në udhëzimet, monitorimet dhe trajnimet e stafëve apo të personave që ndjekin ecurinë e procesit të vetëvlerësimit, si dhe konstatohet që të gjithë ofruesit e AFP-së e kanë vlerësuar si proces dhe besojnë në rezultatin që vetëvlerësimi jep. Ofruesit e AFP-ve e shohin vetëvlerësimin si një instrument efektiv dhe janë përkushtuar për ta përdorur sa më mirë duke përfshirë të gjithë strukturat e tyre të brendshme.

Nga analiza sasiore e vetëvlerësimit në nivel kombëtar duke marrë në konsideratë rezultatin në nivel fushe, duke vëzhguar paraqitjen grafike të mëposhtme shihet se fushat ku ofruesit janë më mirë janë Fusha 1 “Menaxhimi dhe drejtimi”, Fusha 3: “Kurrikula e zbatuar” dhe Fusha 5 “Vlerësimi”. Ndërkohë që nevojitet të përmirësohen më tepër aspektet që lidhen me Fushën 2 “Marrëdhënia dhe bashkëpunimi” dhe Fusha 4 “Mësimdhënia dhe të nxënësit”.



Është me rëndësi të theksohet se ka ende ofrues të cilët kanë paqartësi nëse duhet të plotësojnë nënfusha, tregues apo kriteret e caktuara. Për shembull, janë konstatuar raste kur QFP kanë plotësuar nënfushën “Kurrikula në bazë shkolle”, nënfushë e cila plotësohet vetëm nga ofruesit e AFP-së, të cilët janë shkolla dhe jo qendra të formimit profesional. Raste të tjera janë kur në

vend të kriterëve “Pa vlerësim” ofruesit e AFP-së e vlerësojnë veten “Dobët”. AKAFPK do të gjejë mënyrat e duhura për të informuar dhe mbështetur ofruesit e AFP-së, lidhur me paqartësitë të cilat kanë dalë në pah nga analiza e gjetjeve në këtë raport kombëtar të vetëvlerësimit. Në këtë mënyrë rezultatet e vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së do të jenë më objektive dhe më afër gjëndjes reale.

REKOMANDIME

Pas konstatimit të pikave të forta dhe pikave që kanë nevojë për përmirësim, janë formuluar disa rekomandime për secilën nga nënfushat e pesë fushave të cilësisë.

FUSHA 1: MENAXHIMI DHE DREJTIMI

Nënfusha 1: Gjithëpërfshirja

1. Të gjenden mënyra të përshtatshme për të qasur prindërit në veprimtaritë që lidhen me menaxhimin e ofruesit të AFP-së.
2. Të dokumentohet çdo veprimtari e organizmave zyrtarë të ofruesit të AFP-së të krijuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

Nënfusha 3: Plani vjetor i ofruesve të AFP-së

3. Të ndërtohen mekanizma për të aktivizuar grupet e interesit në hartimin e planit vjetor të ofruesit të AFP-së.
4. Të hartohen objektiva që pasqyrojnë veprimtari me aspekte gjinore, sipas gjendjes së ofruesit në planin vjetor.

Nënfusha 4: Plani i vëzhgimit të orëve mësimore

5. Të merren masa për zhvillimin e mini testeve dhe provimeve nga drejtuesit e ofruesve të AFP-së.
6. Të analizohen dhe dokumentohen gjetjet e orëve të vëzhguara nga drejtuesit e ofruesve.

Nënfusha 7: Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së

7. Të publikohet raporti vjetor i vetëvlerësimit në faqen zyrtare të internetit të ofruesit të AFP-së.

Nënfusha 8: Zhvillimi profesional i stafit

8. Të analizohen rregullisht nevojat për trajnim të mësimdhënësve të ofruesit të AFP-së.

FUSHA 2: MARRËDHËNIA DHE BASHKËPUNIMI

Nënfusha 1: Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore.

9. Të zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me pushtetin lokal.
10. Të dërgohen në rrugë zyrtare ftesat e ofruesve të AFP-së te institucionet e qeverisjes vendore, për aktivitete dhe takime me interes të përbashkët.

Nënfusha 2: Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin

11. Të nënshkruhen kontrata bashkëpunimi sipas kërkesave ligjore me bizneset në të cilat nxënësit/kursantët zhvillojnë praktikat profesionale.

Nënfusha 3: Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin

12. Të nxitet marrëdhënia dhe bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile.

Nënfusha 4: Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve

13. Të rritet numri i bashkëpunimeve nga ofruesit e AFP-së midis vetë ofruesve të AFP-së dhe institucioneve të tjera arsimore.

FUSHA 3: KURRIKULA E ZBATUAR

Nënfusha 2: Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së

14. Të kryhen analiza mbi nevojat e tregut lokal dhe rajonal të punës dhe të dokumentohen rezultatet e nxjerra.

Nënfusha 3: Kurrikula e formimit të përgjithshëm

15. Të pasurohen planet ditore të mësimdhënësve edhe me elementë të barazisë gjinore.

Nënfusha 4: Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

16. Të ndërmerren hapa konkretë për hartimin e teksteve profesionale.

Nënfusha 5: Ekipi kurrikular

17. Të analizohen faktorët se përse prindërit nuk marrin pjesë në mbledhjet e ekipit kurrikular dhe të ndërmerren masat e duhura për të nxitur pjesëmarrjen e tyre.
18. Të dokumentohet veprimtaria e Ekipëve Kurrikulare.
19. Të nxitet bashkëpunimi midis anëtarëve të ekipit kurrikular brenda ofruesit të AFP-së.

FUSHA 4: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Nënfusha 3: Parimet kryesore gjatë orës së mësimi

20. Të planifikohen dhe të realizohen trajnime të stafit mësimdhënës të kulturës profesionale lidhur me “*Parimet kryesore gjatë orës mësimore*” për të aplikuar metoda bashkëkohore të mësimdhënies të cilat synojnë zhvillimin e aftësive ndër kurrikulare të nxënës.

Nënfusha 4: Ana Shkencore

21. Të trajnohen mësimdhënësit lidhur me përdorimin e pajisjeve TIK gjatë orëve mësimore, në ofruesit e AFP-së në të cilët janë evidentuar pikat e dobëta.

Nënfusha 5: Baza materiale dhe didaktike

22. Të nxitet bashkëpunimi i mësimdhënësve me prindërit dhe komunitetin për sigurimin e mjeteve mësimore.

Nënfusha 6: Mjedisi fizik

23. Të adresohen nevojat për rikonstrukcion dhe restaurim të ambienteve nga ofruesit përkatës të AFP-së në institucionet përgjegjëse.

Nënfusha 8: Detyrat e shtëpisë

24. Tu jepet mundësia nxënësve për të vendosur edhe vetë për llojin e detyrave të shtëpisë.

Nënfusha 11: Nxënësit dhe kursanti me nevoja të veçanta

25. Të ndërmerren hapat për të punësuar mësues ndihmës në ofruesit e AFP-së që kanë nxënës me nevoja të veçanta, konform akteve ligjore dhe nënligjore.
26. Të dërgohet kërkesa nga ofruesit e AFP-së në institucionet përgjegjëse për sigurimin e infrastrukturës për nxënësit me aftësi të kufizuara lëvizore.

FUSHA 5: VLERËSIMI

Nënfusha 1: Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit

27. Të aplikohet teknika e “*vetëvlerësimit të nxënësit*” dhe teknika e “*vlerësimit të nxënësve nga nxënësit*” në zhvillimin e orëve mësimore.
28. Të merret në konsideratë edhe vlerësimi i portofolit të nxënësit gjatë vlerësimit të vazhduar.

Nënfusha 2: Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit

29. Të marrin pjesë përfaqësues nga biznesi në komisionet e vlerësimit në Provimet Përfundimtare të praktikës profesionale të nxënësve mbështetur në Udhëzimin nr. 15, datë 26.4.2019 “*Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP*” Neni 10, pika 3.

Nënfusha 4: Arritjet

30. Të analizohen shkaqet e mospërputhjes së vlerësimeve të vazhduara dhe përfundimtare të nxënësve dhe të merren masa për zvogëlimin e kësaj mospërputhjeje.

Nënfusha 6: Ankimimet

31. Të hartohen procedura zyrtare të ankimimit për provimet përfundimtare të nxënësve.